

VENDIM
Nr. 364, datë 30.5.2012

**PËR RISHPËRNDARJEN NË NUMRIN E PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE
BUXHETORE, MIRATUAR PËR VITIN 2012, NGA MINISTRIA E EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 10 e 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, miratuar për vitin 2012, të bëhet rishpërndarja, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik t’i shtohen 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm për këtë institucion, për vitin 2012, në 20 veta.

b) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t’i pakësohen 2 (dy) punonjës, nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të kësaj ministrie, për vitin 2012 në 776 veta.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2012 të bëhet rishpërndarje e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik, në programin “Shërbimi i prokurimit publik”, t’i shtohet fondi i shpenzimeve të personelit me 1 025 000 (një milion e njëzet e pesë mijë) lekë.

b) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, t’i pakësohet fondi 1 025 000 (një milion e njëzet e pesë mijë) lekë, nga shpenzimet e personelit.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha